

Akt Themelimi

I shoqërisë tregëtare “TEMLA” sh.p.k

Mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregëtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare, me vullnetin e tij të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortakët :

Sot më datë 04.07.2021 unë Blerim KAMBERI i biri i Ahmetit person fizik, banues në Tiranë, i identifikuar me Nr letërnjoftimi 033915243 i lindur më 29.04.1969 në Dibër kam krijuar një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin tregëtar, **TEMLA sh.p.** me akt themelimi si vijon :

Neni 1

Formulimi

Formohet shoqëria tregëtare private e quajtur “**TEMLA**” sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Selia e Shoqërisë


Selia e shoqërisë tregëtare private ndodhet në teritorin e Bashkisë Divjakë, komuna Rremas, fshati Muçias, zona kadastrale 2728, nr. i pasurisë 168/16. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë e të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm .

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitete në fushën e :

- Import-eksport, tregëtimin me shumicë e pakicë i te gjitha llojeve të peshkut
- Grumbullim dhe eksportimi i peshkut. Tregëtimi i tij me shumicë e me pakicë i tij brenda dhe jashtë vendit
- Importimit të produkteve detare të ngrira dhe ushqimore në përgjithësi
- Tregëtim me shumicë e pakicë te materialeve të peshkimit
- Akuakulturë
- Ndërtim projektim kapanonesh frigoriferike
- Ndërtim projektim objektsh bujqësore, blegtorale e përpunuese
- Ndërtim projektim serash



- Eksport.Transport për të tretë.
- Prodhim, paketim, etiketim, regjim të përpunimit aktiv të produkteve bujqësore, blektorale dhe detare,
- Import eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakice si artikuj të ndryshëm industriale, ushqimore, bujqësore e blegtorale, fruta perime,medikamenteve të ndryshme dhe barnave të ndryshme bujqësore e blektorale.
- Mbjellje, rritje, dhe përpunim i të gjitha prodhimeve bujqësore
- Import dhe eksport i të gjitha prodhimeve bujqësore të freskëta e të paketuara
- Blerjen e farave, fidanëve, medikamenteve për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Ngritjen linjave përpunuese
- Eksport import, shitje linjash teknologjike,
- Prodhim dhe ambalazhim të produkteve ushqimore agro-përpunuese,
- Bar-kafe, Restorant
- *Si dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje sa më sipër dhe të lejuar nga ligji.*

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkak .

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë “TEMLA” sh.p.k do të jetë **100.000 (një qind mijë lekë).**

Kapitali është 100% nga kuotat e ortakut të vetëm , e ndarë në **1 kuota.**

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Neni 6


Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj , Z.Blerim KAMBERI si përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka Kompetenca të plota në drejtimin e saj për një periudhe 5 (pesë) vjeçare.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm .



Neni 8

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë të emëroje dhe administratore të tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financiarë , likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë .

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregëtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12


Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ **TEMLA** ” sh.p.k

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortak i vetëm themelues i shoqërisë

“ **TEMLA ” sh.p.k**

Blerim KAMBERI



STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ TEMLA”sh.p.k.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

Neni 1

Krijimi


Sot më datë 04.07.2021 unë Blerim KAMBERI i identifikuar me Nr leternjoftimi 033915243 I lindur më 29.04.1969 në Dibër kam krijuar një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin **TEMLA sh.p.k** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitete në fushën e :

- Import-eksport, tregëtimin me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të peshkut
- Grumbullim dhe eksportimi i peshkut. Tregëtimi i tij me shumicë e me pakicë i tij brenda dhe jashtë vendit
- Importimit të produkteve detare të ngrira dhe ushqimore në përgjithësi
- Tregëtim me shumicë e pakicë të materialeve të peshkimit
- Akuakulturë
- Ndërtim projektim kapanonesh frigoriferike
- Ndërtim projektim objektsh bujqësore, blegtorale e përpunuese
- Ndërtim projektim serash
- Eksport.Transport për të tretë.
- Prodhim, paketim, etiketim, regjim të përpunimit aktiv të produkteve bujqësore, blektorale dhe detare,
- Import eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakicë si artikuj të ndryshëm industriale, ushqimore, bujqësore e blegtorale, fruta perime,medikamenteve të ndryshme dhe barnave të ndryshme bujqësore e blektorale.
- Mbjellje, rritje, dhe përpunim i të gjitha prodhimeve bujqësore
- Import dhe eksport i të gjitha prodhimeve bujqësore të freskëta e të paketuara
- Blerjen e farave, fidanëve, medikamenteve për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Ngritjen linjave përpunuese
- Eksport import, shitje linjash teknologjike,
- Prodhim dhe ambalazhim të produkteve ushqimore agro-përpunuese,
- Bar-kafe, Restorant
- *Si dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje sa më sipër dhe të lejuar nga ligji.*



1

Neni 3

Selia

Shoqëria ka Seli në adresën “**Bashkia Divjakë, komuna Rremas, fshati Muçias, zona kadastrale 2728, nr. i pasurisë 168/16.**” .Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese dhe ortakut të vetëm. Transferimi i selisë brenda të njëjtës Bashki mund të vendoset nga organi administrativ dhe nuk do të sjellë modifikimin e statutit. Me vendim të Organit administrativ, shoqëria mund të krijojë dhe suprimojë agjensi, zyra dhe filiale edhe tjetërkund ndërkohë që për krijimin dhe suprimimin e tyre jashtë shtetit, krijimin e selive sekondare si në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe për transferimin e selisë së shoqërisë në rrethe të tjera, është e nevojshme vendimarrja e ortakëve në mbledhje të asamblesë.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë)** lekë i përbërë nga **1 kuota** dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë si me poshte :


Ortaku Themelues: Blerim KAMBERI , zotërues i **1 kuote** me vlerë të **përgjithëshme 100.000 lekë (njëqind mijë)**, të cilat përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë,

Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar **100.000 Lekë (njëqind mijë)**

Vlera Totale e Kapitalit të Paguar **100.000 Lekë (njëqind mijë)**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhëroje ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga çasti i cënimit.



Neni 6

Kërkesa për të paguar Kuota dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- 1- Administratorët mund të kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak pas marrjes së njoftimit prej 10 ditëve i paguan shoqërisë shumën për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë dhe pagesën me këste të kontributeve të papaguara. Personit të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilët lidhet njoftimi për pagesë.
- 2- Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkarisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treteve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.


Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.


Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asambленe e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambленe e përgjithëshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes së Asamblese së Përgjithëshme

Asambleja e përgjithëshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në se të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi


- a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithëshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në se marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.
- b) Në rastin kur asambleja e përgjithëshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në se ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Në se asambleja e përgjithëshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, më të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithëshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit. kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e ekspertëve dhe likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme kur në të janë të pranishëm ortakët më të drejtë vote që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilët votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës.

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be 'Blaw' followed by a flourish.

Asambleja e përgjithëshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote të cilët zotërojnë me shumë se 30 % të kuotave për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

KREU IV

ADMINISTRATORET

Neni 13

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.


Administrator i shoqërisë është **Z. Blerim Kamberi** me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili do të ushtrojë detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit për një **periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje**. Asambleja e përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë më shumicë të zakonëshme. Statuti, apo marreveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkeje të ligjit me kërkesë të çdo njërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërise.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithëshme
- b) përfaqësojë shoqërinë tregëtare



6

- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithëshme për miratim,
- e) krijojë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) kryejë regjistrimet dhe të dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit
- g) raportojë përpara asamblese së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asmblesë së ortakeve edhe në rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transferta etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore etj, në të gjitha rrethanat me perjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet më të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 15

Përgjegjësitë


Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëme shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithëshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" administratori detyrohet:

1.

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tëresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.



- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyëshme me qëllimet e shoqërisë tregëtare me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vleresimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Në se administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e proves për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara në se në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare , kryen veprimet e mëposhtme:


- a) u kthen ortakeve kontributet
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividende
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregëtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, në se është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.



Neni 17

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar mbledhja e ortakëve miraton bilancin e paraqitur nga administratori/et. Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregëtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakëve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë


- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) në se nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) me vendim të gjykatës.

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër"

Prishja e shoqërive tregëtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Në se Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.



9

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Në se shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveç se kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit i ushtrojnë bashkarisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre që të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u drejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Te drejtat dhe detyrimet e likuiduesit


1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 to Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Në se, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare " likuiduesit vërejnë së pasuria e shoqërisë tregëtare, përfshirë kontributet e pashlyera nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit nje bilanc të gjendjes së shoqërisë në rastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në rastin e mbylljes së këtyre procedurave. Në se procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit likuiduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 23

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes se aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



Neni 24

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërës ose me shumë prej shoqërive, që quhen shoqërite e përthithura te një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithese, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 25


Ndarja

- 1) Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë së ortakeve duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
- 2) Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
- 3) Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet quhen shoqëri pritese dhe përgjigjen në mënyre solidare për detyrimet e kesaj të fundit.
- 4) Regjistrimi i ndarjes së shoqërise pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasoje:
 - a) kalimin tek shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive si dhe për palët e treta
 - b) berjen e aksionareve/ortakeve të shoqërisë që ndahet aksionare apo ortakeve të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.
 - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723. datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 26

Shndërrimi

Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



11

Neni 27

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar .Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do to zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente gjykata shiptare.

Neni 29

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 kopje me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga ortakët e shoqërisë tregëtare " **TEMLA** " sh.p.k. Nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKET

Blerim KAMBERI

